

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 45, datë 12.4.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR APLIKIM PËR FITIMIN
E SHTETËSISË SHQIPTARE NËPËRMJET PROGRAMIT TË VEÇANTË TË
SHTETËSISË NË FUSHËN E ARTIT, KULTURËS, ARSIMIT, SHKENCËS DHE
SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, vendimit nr. 1008, datë 25.11.2020 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë” dhe të shkronjës “c” të pikës 1, të vendimit të nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për veprime dhe shërbime që kryhen nga Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë janë si më poshtë:

a) tarifë për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës;

b) tarifë për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e arsimit, shkencës e sportit.

2. Tarifat e shërbimit (pagesat) për shërbimet e pikës 1 të këtij udhëzimi përcaktohen në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve administrative.

4. Tarifa paguhet në emër të Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë dhe derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

5. Ngarkohen Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

SHTOJCË NR. 1

Tarifat për veprime dhe shërbime që kryhen nga Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë janë përkatësisht:

a) tarifa për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës: 7 500 lekë;

b) tarifa për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e arsimit, shkencës e sportit: 7 500 lekë.